

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 07.03.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2024, pas shqyrtimit të kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 0-36/1, të datës 13.02.2024, për rishqyrtimin e Rregullores për Transparencë Nr. 228, të datës 29.12.2023, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 20/2016), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

**Për rishqyrtimin e Rregullores për Transparencë Nr. 228, të datës 29.12.2023 në
Komunën e Fushë-Kosovës**


1. Për rishqyrtimin e Kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 0-36/1, të datës 13.02.2024, lidhur me ligjshmërinë e Rregullores për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës Nr. 228, të datës 29.12.2023, me aprovimin e kërkesës për ndryshim-plotësimin dhe harmonizim e kësaj rregullore me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023, për Administratë të Hapur në Komuna.
2. Kuvendi i Komunës e autorizon Grupin Punues të formuar me vendimin Nr. 17, të datës 04.02.2022 nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës për përgatitjen e ndryshim - plotësimit të Rregullores për Transparencë.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për
ADM dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 07.03.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 420, të datës 20.02.2024, paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, g, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 10, paragrafi 10.2, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, f, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për aprovimin e Propozimit Nr. 420, të datës 20.02.2024 për lirimin nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve ekonomike të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 420, të datës 20.02.2024, për vazhdimin e lirimit të bizneseve nga pagesa e taksës komunale për vitet 2023, 2024 dhe 2025, për të gjitha subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në funksion të krijimit të lehtësimeve për bizneset ekzistuese dhe avantazhe për hapjen e bizneseve të reja dhe gjenerim të punësimit.
2. Lirimi i subjekteve afariste nga taksa komunale e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike nga viti 2017-2022, me vendimet e Kuvendit të Komunës dhe vazhdimin e lirimit për periudhën e ardhshme të evidentuar në pikën një të vendimit, synon ruajtjen e vendeve të punës dhe rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik lokal nga Sektori privat në fushën e veprimtarive të tregtisë, shërbimeve, ndërtimtarisë, prodhimit, akomodimit dhe mikro - bizneseve, ku përfitues tani janë gjithsej 2750 biznese, të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe bënë pezullimin e zbatimit të nenit 8, të Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 63, të datës 16.05.2013.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për ZHE dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 07.03.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2024, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 427, të datës 22.02.2024, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (ç), nenin 17, shkronja (m), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 18, të Ligjit për Shëndetësinë Nr. 04/L-125, (Gazeta Zyrtare Nr. 13/2023), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (i), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

**Për aprovimin në parim të Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë
Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë**

1. Për aprovimin në parim të 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë' dhe procedimin e tij për diskutim publik.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për SHMS dhe Arkivës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili**

